

VENDIM
Nr.79, datë 17.2.2007

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA MJEDISEVE TË “ALBA FILM STUDIO” SHA, NGA MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TE MINISTRIA E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të “Alba Film Studio” sh.a., nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve te Ministria e Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorisë së PMNSH-së), sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorisë së PMNZSH-së) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[illegible]

TIRANE

PJESA E OBJEKTIT QE KERKOHET



4/109
3/1
3/2

